



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE

Nr. 1104 / Prot
4

Tiranë, më 14.11.2016

VENDIM

Nr. 74, datë 14.11.2016

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, Ligjit Nr.44/2015, datë 30.04.2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit Hotel "Jolly"- Molino sh.p.k. Lezhë, me aktivitetin e tij në formën ligjore person juridik,

VËREJ SE :

Në zbatim të Urdhërit Nr. 222, datë 12.10.2016 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, për kryerjen e hetimit administrativ, më datë 20.10.2016 e në vazhdim, grupi i inspektimit filloi procesin e hetimit administrativ pranë kontrolluesit, Hotel "Jolly" - Molino sh.p.k. Lezhë, me objekt:

- Zbatimi i Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, dhe akteve të miratuara nga Komisioneri, në lidhje me mbledhjen përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit të kontrolluesit, Hotel "Jolly" - Molino sh.p.k., Lezhë.

Grupi i kontrollit, gjatë kryerjes së veprimeve proceduriale, u asistua nga përfaqësuesi i kontrolluesit, i cili ishte njohur me Urdhërin Nr.222, datë 12.10.2016 të Komisionerit për kryerjen e hetimit administrativ që do të ushtrohej pranë këtij kontrolluesi.

Përfaqësuesi i kontrolluesit për arsye subjektive kërkoi shtyrjen e kontrollit për ditën e nesërme, kërkesë e cila ju mundësua, por ai nuk u paraqit duke konsumuar dukshëm nenin 32 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.

Grupi i kontrollit i gjendur në këto kushte, hartoi proces verbalet përkatëse të datave 20 dhe 21.10.2016.

Nga verifikimet e kryera prej grupit të kontrollit konstatohet se:

- Kontrolluesi nuk e ka kryer “Njoftimin” pranë Zyrës së Komisionerit, në lidhje me përpunimin e të dhënave personale gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij.
- Kontrolluesi mbikëqyr ambientet e brendshme nëpërmjet sistemit të video – vëzhgimit (CCTV) dhe nuk informon subjektet e të dhënave mbi prezencën e tij.
- Kontrolluesi nuk ka publikuar politikën e privatësisë në portalin <http://www.jolly-group.al>.
- Kontrolluesi shmangu grupin e kontrollit për zbatimin e Urdhërit Nr.222, datë 12.10.2016 të Komisionerit.

Faktet e sipërme përbëjnë shkelje administrative të neneve 18, 21 dhe 32 të Ligjit Nr. 9887/2008 për “Mbrotjen e të dhënave personale” i ndryshuar.

Konstatimet e procesverbaleve të mbajtura nga grupi i kontrollit, kontrolluesit i janë vënë në dispozicion duke ia komunikuar zyrtarisht ato me shërbimin postar.

Si prova këtij procesverbali i bashkëngjiten këto dokumente:

1. Verifikim në Regjistrin Elektronik të Kontrolluesve.
2. Fotografi nga ambientet në të cilat ushtron aktivitet kontrolluesi.
3. Printim nga faqja zyrtare e kontrolluesit, <http://www.jolly-group.al>.

Zyra e Komisionerit, sjell në vëmendje të kontrolluesit Hotel “Jolly” - Molino sh.p.k. Lezhë:

1. Mos plotësimi i Formularit të Njoftimit përbën shkelje serioze, pasi është procesi fillestar i mbrotjes së të dhënave personale, dhe për mos përmbushjen e këtij detyrimi, kontrolluesi penalizohet sipas nenit 39, paragrafi 1, gërma “d”, të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për Mbrotjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, i cili shprehet: *“..kontrolluesit që nuk përmbushin detyrimin për të njoftuar, sipas përcaktimit në nenin 21 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 500 000 lekë”.*
2. Mungesa e tabelave informuese në ambientet ku instalohen dhe veprojnë kamerat e vëzhgimit (CCTV) dhe mungesa e rubrikës “Politikat e privatësisë”, përbëjnë shkelje të nenit 18 të Ligjit, Nr.9887, datë 10.03.2008, “Për Mbrotjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, i penalizueshëm sipas nenit 39, paragrafi 1, gërma “b”, i cili shprehet: *“...kontrolluesit që nuk përmbushin detyrimin për të informuar, të përcaktuar në nenin 18 të këtij ligji, dënohen me nga 10 000 deri në 300 000 lekë”.*
3. Neni 32 i Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, “Për Mbrotjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar shprehet:
“1. Institucionet publike dhe private bashkëpunojnë me komisionerin, duke i siguruar të gjithë informacionin që ai kërkon për përmbushjen e detyrave, si dhe e njoftojnë atë për

zbatimin e rekomandimeve të dhëna menjëherë pas mbarimit të afatit të caktuar për kryerjen e tyre.

2. Komisioneri ka akses në sistemin e kompjuterëve, në sistemet e arkivimit, që kryejnë përpunimin dhe transferimin e tyre, për ushtrimin e të drejtave dhe të detyrave që i janë ngarkuar me ligj.”

Mos zbatimi i nenit 32 Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, penalizohet sipas nenit 39, pika 1, gërma *dh/1*, i cili shprehet:

“..kontrolluesit dhe përpunuesit që veprojnë në kundërshtim me pikën 2 të nenit 32 të këtij ligji, dënohen me 100 000 deri në 1 000 000 lekë”.

Në zbatim të neneve 87-89 të Ligjit Nr. 44/2015, datë 30.04.2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, përpara marrjes së aktit final, kontrolluesi Hotel “Jolly” - Molino sh.p.k. Lezhë, është njoftuar zyrtarisht për pjesëmarrje në seancë dëgjimore që do zhvillohej në datë 10.11.2016, në ushtrim të së drejtës për tu dëgjuar. Ky kontrollues nuk u paraqit në seancë dhe as ka reaguar në lidhje me shkeljet e konstatuara nga grupi i kontrollit.

Për sa më sipër Zyra e Komisionerit konkludon se, shkeljet e konstatuara gjatë ushtrimit të hetimit administrativ në kuptim të nenit 39 pika 1, gërmat “b”, “d” dhe “dh/1” të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, janë serioze dhe si të tilla, këto shkelje përbëjnë “kundërvajtje administrative”, të cilat sanksionohen me gjobë.

Kontrolluesi Hotel “Jolly” - Molino sh.p.k. Lezhë në formën ligjore të aktivitetit të tij është person juridik dhe sipas nenit 39/2 për kundërvajtjet e mësipërme, dënohet me dyfishin e gjobës së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Komisioneri ka parasysh faktin se shkeljet e konstatuara konsistojnë në moszbatim të ligjit, akteve nënligjore dhe parimeve bazë të mbrojtjes së të dhënave personale. Ato lidhen me cënimin e sigurisë së të dhënave personale të subjekteve të të dhënave, kryesisht për kategorinë “klient”.

PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të neneve 18, 21, 32, 39 pika 1, gërmat “b”, “d”, “dh/1” si dhe nenit 39, pika 2 e Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Dënimin e kontrolluesit Hotel “Jolly” - Molino sh.p.k. Lezhë, me gjobë në vlerën **30 000 (tridhjetë mijë) lekë** për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 18 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar.

2. Dënimin e kontrolluesit Hotel "Jolly" - Molino sh.p.k. Lezhë, me gjobë në vlerën **30 000 (tridhjetë mijë) lekë** për shkeljen e detyrimit të përcaktuar në nenin 21 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.
3. Dënimin e kontrolluesit Hotel "Jolly" - Molino sh.p.k. Lezhë, me gjobë në vlerën **200 000 (dyqind mijë) lekë**, për shkeljen e detyrimit të përcaktuar në nenin 32 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.
4. Kontrolluesi, Hotel "Jolly" - Molino sh.p.k. Lezhë, brenda një periudhe 5 (pesë) ditore nga dalja e këtij vendimi, të përmbushë detyrimin për njoftim pranë Zyrës së Komisionerit.
5. Kontrolluesi, Hotel "Jolly" - Molino sh.p.k. Lezhë, brenda një periudhe 5 (pesë) ditore nga dalja e këtij vendimi, të marrë masat për pajisjen e ambienteve me tabela informuese, si dhe të integrojë në faqen e tij zyrtare, rubrikën "Politikat e privatësisë".
6. Kontrolluesi, Hotel "Jolly" - Molino sh.p.k. Lezhë ka detyrimin të njoftojë Zyrën e Komisionerit, mbi përmbushjen e detyrimeve që burojnë nga ky akt.
7. Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij vendimi. Me kalimin e afatit të ankimit, ky vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga zyra e përmbartimit.
8. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij vendimi.

Ky vendim u shpall sot, më 4.11.2016

